



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 15 korrik 2026, Trupi Gjykses lëshoi një vendim në lidhje me një kërkesë të re të Kadri Veselit për lirim të përkohshëm në kuadër të rishikimit të përdymuajshëm nga gjykatësit nëse paraburgimi është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm. Trupi Gjykses vendosi që të vazhdonte paraburgimin e z. Veseli dhe hodhi poshtë kërkesën e tij për lirim të përkohshëm.

Në vendim, Trupi Gjykses vlerësoi, bazuar në standardin përkatës, se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Veseli do të pengojë ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara dhe të kryejë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen si kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë dëshmitarë që kanë dhënë dëshmi në çështjen gjyqësore.

Gjykatësit vlerësuan veças nëse këto rreziqe mund të trajtohen mjaftueshëm me anë të kushteve për lirin e tij. Ata konstatuan se rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm nëpërmjet kornizës për mbikëqyrjen e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Trupi Gjykses vlerësoi se mekanizmat e incizimit në objektin e paraburgimit dhe punonjësit e Zyrës Administrative, marrë në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër rrezikut që lidhet me komunikimet e paligjshme. Gjykatësit konstatuan gjithashtu se masat në fuqi ofrojnë një mjedis të kontrolluar, ku një shkelje e mundshme mund të identifikohet dhe/ose parandalohet më lehtë.

Trupi Gjykses shqyrtoi gjithashtu nëse zgjatja e afatit për shqiptimin e Aktgjykimit, i planifikuar të mbahet më 16 shtator, është faktor relevant që ndikon në arsyeshmërinë e paraburgimit. Duke pasur parasysh disa faktorë, si rreziqet e vazhdueshme të pengimit të procesit dhe kryerjes së veprave penale të tjera, Trupi Gjykses konstatoi se paraburgimi i z. Veseli edhe për dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat konkrete të çështjes gjyqësore. Trupi Gjykses pranoi se z. Veseli ka kaluar tashmë një kohë të gjatë në paraburgim, dhe se gjykimi në këtë çështje është i gjatë.

Gjykatësit theksuan gjithashtu se kanë punuar sa më shpejt që ka qenë e mundur që Aktgjykimi të dalë pa vonesë, duke vënë në dukje se kohëzgjatja mesatare për kuvendime në tribunale penale ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuar në këto lloj çështjesh gjyqësore ka qenë 395,2 ditë.

Në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*, çështja u mbyll më 18 shkurt 2026 dhe aktgjykimi është planifikuar të shqiptohet më 16 shtator 2026, përafërsisht shtatë muaj më pas. Në vendimin e tij, Trupi Gjykses theksoi se do të vazhdojë të monitorojë gjatë çdo faze të procesit nëse paraburgimi është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.





Në të njëjtën çështje gjyqësore, po më 15 korrik, Trupi Gjykses vendosi të vazhdonte paraburgimin e Jakup Krasniqit dhe hodhi poshtë kërkesën e tij për lirim të përkohshëm. Gjykatësit konstatuan se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të pengojë ecurinë e procesit dhe të kryejë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen si kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë dëshmitarë.

Trupi Gjykses rikujtoi gjithashtu konstatimin e vet, të konfirmuar Paneli i Gjykatësi së Apelit, se rreziku i ndërhyrjes përfshin gjithashtu: (i) përpjekjet për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve që kanë dëshmuar në këtë proces; dhe (ii) përpjekjet për të nxitur dëshmitarët të tërheqin dëshmitë. Gjykatësit vunë në dukje se pavarësisht fazës aktuale të çështjes, lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte në mbrojtjen efikase të dëshmitarëve.

DHSK-ja këtë javë po vazhdon me publikimin e një numri videomateriale, "Një Vështrim mbi Mandatin dhe Punën e Dhomave të Specializuara", ku trajtohen drejtpërdrejt pyetjet më të shpeshta në lidhje me Gjykatën. Këto videomateriale mund t'i gjeni në shqipe, serbishte dhe anglishte në faqen e internetit të DHSK-së dhe mund të shikohen në kanalet e Dhomave të Specializuara në *YouTube*, *X*, dhe *Instagram*.

